

RRETH KURSIMIT



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

QËLLIMET E MËSIMNXËNIES

- PËRKUFIZIMI I KURSIMIT
- ARSYET PSE KURSIMET JANË TË RËNDËSISHME
- SI TË KURSEJMË
- RREGULLI 50/30/20
- RREGULLI I 30 DITËVE



ÇKA PARAQESIN KURSIMET?

- **KURSIMET** JANË “SHUMA E PARASË TË CILËN JU NUK KENI NEVOJË TA PËRDORNI APO SHPENZONI.”


OXFORD ONLINE DICTIONARY

- **KURSIMET** “PARAQESIN PROCESIN E VENDOSJES ANASH TË NJË PJESE TË TË ARDHURAVE TË TASHME PËR T’I PËRDORUR NË TË ARDHMEN. KURSIMI MUND TË MARRË FORMËN E RRYTJES SË MJETEVE TË DEPOZITUARA NË BANKË, BLERJES SË BONOVE TË THESARIT OSE RRYTJES SË SHUMËS SË PARAVE TË GATSHME.”

ENCYLOPAEDIA BRITANNICA

KURSIMI DO TË THOTË NDARJA E MJETEVE ANASH, QË TË MUND T’I PËRDORIM MË VONË.

[BROSHURA-1-FINAL-FINAL.PDF \(BQK-KOS.ORG\)](#)



A KA KURSYER FAMILJA E ZANËS?

LE TË NJEHËSOJMË KURSIMET MUJORE TË FAMILJES SË ZANËS NË BAZË TË PLANIT BUXHETOR!

GJITHSEJ TË ARDHURAT	2.500 EURO
- <u>GJITHSEJ SHPENZIMET</u>	<u>1.700 EURO</u>
KURSIMET	800 EURO

PLANI BUXHETOR MUJOR I FAMILJES SË ZANËS

BURIMET E TË ARDHURAVE	SHUMA E TË ARDHURAVE	LLOJET E SHPENZIMEVE	SHUMA E SHPENZIMEVE
Të ardhurat familjare	1500	Ushqimi	800
Të ardhurat nga qiraja	400	Sigurimi i veturës	20
Paga e Zanës	300	Shërbimet publike	20
Remitencat nga ANDRA	300	Energjia elektrike	50
		Kujdesi personal	60
		Veshmbathja	300
		Komunikimi dhe TV kabllor	50
		Argëtimi	200
		Shpenzimet e papritura	200
Gjithsej të ardhurat	2500	Gjithsej shpenzimet	1700
Bilanca (= Gjithsej të ardhurat – Gjithsej shpenzimet)	800		

PSE JANË KURSIMET TË RËNDËSISHME PËR FAMILJEN E ZANËS?

1. KURSIMET MUND TË NDIHMOJNË FAMILJEN E ZANËS QË TË ARRIJË QËLLIMET FINANCIARE, PËR SHEMBULL
 - TË INVESTOJË NË BIZNES
 - TË BLEJË NJË SHTËPI APO BANESË, OSE
 - TË KURSEJË NË BANKË PËR KOHËN E PENSIONIMIT APO PËR EMERGJENCA SHËNDETËSORE
2. KURSIMET MUND TË NDIHMOJNË FAMILJEN E ZANËS QË TË FITOJNË MË SHUMË PARA PËRMES
 - TË HYRAVE BIZNESORE
 - TË HYRAVE NGA QIRAJA
 - NORMËS SË INTERESIT NË MJETET E DEPOZITUARA NË BANKË
3. KURSIMET MUND TË NDIHMOJNË FAMILJEN E ZANËS PËR TË MBULUAR SHPENZIMET E PAPRITURA, PËR SHEMBULL
 - SHPENZIMET SHËNDETËSORE
 - SHPENZIMET NË RIPARIME NË SHTËPI, VETURË ETJ...

SI DUHET TË KURSEJË FAMILJA E ZANËS?

ATA DUHET TË:

1. ÇAKTOJNË QËLLIMIN E TYRE TË KURSIMIT
2. KONSIDEROJNË ZBATIMIN E RREGULLËS 50/30/20
3. REDUKTOJNË SHPENZIMET JOBAZIKE
4. PAGUAJNË SË PARI VETEN E TYRE
5. ZBATOJNË RREGULLËN E 30 DITËVE PËR TË REDUKTUAR SHPENZIMET E PANEVOJSHME

TË ÇAKTOJNË QËLLIMIN E TYRE TË KURSIMIT

QËLLIMET E MUNDSHME TË KURSIMIT



TË CAKTOJNË QËLLIMIN E TYRE TË KURSIMIT

TË ZGJEDHIN QËLLIMIN E TYRE TË KURSIMIT

1

INVESTIM NË BIZNES

2

BLERJE E SHTËPISË APO
BANESËS

3

KURSIME NË BANKË
PËR KOHËN E
PENSIONIMIT OSE
EMERGJENCA
SHËNDETËSORE

TË ZGJEDHIN QËLLIMIN E TYRE TË KURSIMIT

- PUNA NË NJË SHOQATË BIZNESI DHE PRANIMI I REMITENCAVE E KA MOTIVUAR ZANËN PËR TË FILLUAR BIZNESIN E SAJ
- PASIQË KA DISKUTUAR IDETË E BIZNESIT ME ANDRËN DHE FAMILJEN, TË GJITHË SË BASHKU KANË VENDOSUR TË INVESTOJNË NË NJË FURRË BUKE



TË IDENTIFIKOJNË BURIMET E NEVOJSHME PËR TË ARRITUR QËLLIMIN BIZNESOR

- KURSIME
 - TË MBLEDHIN KURSIME MUJORE
- REMITENCA
 - TË MBLEDHIN REMITENCAT QË I DËRGON ANDRA
- KREDI BANKARE
 - TË APLIKOJNË PËR NJË KREDI BANKARE NË RAST NEVOJE

TË PËRCAKTOJNË SHUMËN E NEVOJSHME TË INVESTIMIT

KJO ËSHTË VLERËSUAR NË BIZNES PLAN, NË NJË MODUL TË MËVONSHËM

INVESTIM NË BIZNES
12.000 EURO

Qëllimi: Të kursejnë 12.000€

Koha: Brenda 1 viti

Si: Të kursejnë 500€ në muaj, 6.000€
brenda 1 viti

300€ remitenca në muaj, 3.600€
brenda 1 viti

Atyre iu duhen edhe 2.400€

**Atyre iu duhen edhe
2.400€**

TË PËRCAKTOJNË SHUMËN E NEVOJSHME TË INVESTIMIT


PËR TË SIGURUAR EDHE 2.400€, *FAMILJA E ZANËS MUND TË:*

- RRIT KURSIME T
- TË VENDOS ANASH NJË SHUMË MË TË MADHE PARASH SI KURSIME MUJORE
- RRIT REMITENCAT
- TË KËRKOJNË NGA ANDRA QË T'IU DËRGOJË NJË SHUMË MË TË MADHE TË REMITENCAVE MUJORE
- APLIKOJË PËR KREDI BANKARE

TË ZBATOJNË RREGULLËN 50/30/20

- NJË RREGULLË E LEHTË PËR TË NDARË TË ARDHURAT NË TRI KATEGORI DHE PËR TË KURSYER:
 - 50% NEVOJAT
 - 30% DËSHIRAT
 - 20% KURSIMET

50/30/20 rule



TË ZBATOJNË RREGULLËN 50/30/20

DALLIMI NË MES TË NEVOJAVE DHE DËSHIRAVE

SHPENZIMET BAZIKE KUNDREJT ATYRE JOBAZIKE

- **PËRAFËRSISHT 50% E TË ARDHURAVE TOTALE**
DUHET T'I SHPENZONI PËR GJËRA TË NEVOJSHME = SHPENZIMET BAZIKE
 - GJËRAT PËR TË CILAT KENI NEVOJË
 - PËR SHEMBULL
 - USHQIM
 - QIRA
 - KTHIM KREDIE
 - SHËRBIMET PUBLIKE
 - SHKOLLIM
- **JO MË SHUMË SE 30% E TË ARDHURAVE TOTALE**
DUHET T'I SHPENZONI NË GJËRA TË CILAT I DËSHIRONI = SHPENZIMET JOBAZIKE
 - GJËRAT QË JU I DËSHIRONI, POR PËR TË CILAT NUK KENI NEVOJË
 - PËR SHEMBULL
 - RESTORANTE
 - VESHMBATHJE
 - ARGËTIM
 - ANËTARËSIM NË PALESTER FITNESI
 - DHURATA/ DONACIONE

TË ZBATOJNË RREGULLËN 50/30/20

- **TË PAKTËN 20% TË TË ARDHURAVE TOTALE DUHET T'I KURSENI**

TË PARANDALOJNË SHPENZIMET JOBAZIKE

A më duhen të gjitha këto gjëra jo të domosdoshme?

A mund të shpenzoj më pak në disa prej këtyre gjërave jo të domosdoshme?



TË PARANDALOJNË SHPENZIMET JOBAZIKE

A më duhet patjetër të ha në restorant?

A më duhet patjetër të dal për çdo ditë dhe të shikojë filma në kinema?

A më duhen patjetër të gjitha rrobat që po i blej?



JO – unë mund të ha në shtëpi!

JO – unë mund të shikoj filma në shtëpi

JO – unë mund të blej rroba më pak dhe me çmime më të lira?



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

TË PAGUAJNË VETEN SË PARI

- SIPAS RREGULLËS 50/30/20, FAMILJA E ZANËS DUHET TË KURSEJË SË PAKU 20% TË TË ARDHURAVE TË TYRE
- KËSHTU, FAMILJA E ZANËS IA KA CAKTUAR VETES SI QËLLIM QË TË KURSEJË 500€ NË MUAJ
- GJËJA E PARË QË DUHET TA BËJNË, NË DITËN E PARË TË MUAJIT ËSHTË QË TË NDAJNË ANASH 500€
- ATA DUHET T'I TRAJTOJNË KËTO KURSIME PREJ 500€ NË MUAJ SI NJË DETYRIM

RREGULLA E 30 DITËVE PËR KURSIM ËSHTË E THJESHTË

- NJË RREGULLË E THJESHTË PËR TË KURSYER NË GJËRA TË DOMOSDOSHME
- KUR JU DONI TË BËNI BLERJE IMPULSIVE, NDALENI VETEN DHE MENDONI PËR KËTË BLERJE PËR 30 DITË
- **PAS 30 DITËSH, ZAKONISHT DO TA KUPTONI QË NUK KENI NEVOJË PËR ATË GJË**



BLERJA IMPULSIVE NËNKUPTON “BLERJEN E GJËRAVE PA PLANIFIKIM PARAPRAK DHE TË KUJDESSHËM RRETH BLERJEVE”

OXFORD DICTIONARY ONLINE

PSE DËSHTOJNË NJERËZIT TË KURSEJNË?

- JU MUNGON PLANI BUXHETOR
- JU MUNGOJNË QËLLIMET SPECIFIKE
- MBAJNË QËNDRIM NEGATIV
- JU MUNGON NXITJA
- KANË PRITJE JOREALE



PYETJA 1

- KURSIMET JANË:
 - A. DALLIMI NË MES TË TË ARDHURAVE TOTALE DHE SHPENZIMEVE TOTALE
 - B. TË ARDHURAT TOTALE MINUS SHPENZIMET TOTALE
 - C. SHUMA E PARAVE TË CILËN NUK KENI NEVOJË TA SHPENZONI
 - D. TË GJITHA

PYETJA 2

- PSE DËSHTOJMË TË KURSEJMË:
 - A. NA MUNGON NXITJA
 - B. NA MUNGOJNË QËLLIMET SPECIFIKE
 - C. A DHE B
 - D. ASNJËRA

PYETJA 3

- KURSIMET MUND TË NA NDIHMOJNË TË ARRIJMË QËLLIMET TONA FINANCIARE
 - A. E SAKTË
 - B. E PASAKTË

PYETJA 4

- PËR TË KURSYER, NE DUHET TË:
 - A. TË CAKTOJMË QËLLIME SPECIFIKE TË KURSIMIT
 - B. ZBATOJMË RREGULLËN 50/30/20
 - C. TË PAGUAJMË VETEN SË PARI
 - D. TË GJITHA

PYETJA 5

- PËR TË PARANDALUAR SHPENZIMET JOBAZIKE, KUR JU DONI TE BËNI **BLERJE IMPULSIVE** ,
NDALUNI DHE MENDONI PËR KËTË PËR 30 DITË.
 - A. E SAKTË
 - B. E PASAKTË

REFERENCAT

- [HTTPS://TEMPLATES.OFFICE.COM/EN-US/PERSONAL-MONTHLY-BUDGET-SPREADSHEET-TM16410113](https://templates.office.com/en-us/personal-monthly-budget-spreadsheet-tm16410113)
- [HTTP://WWW.PRACTICALMONEYSKILLS.COM](http://www.practicalmoneyskills.com)
- [HTTPS://PLAYMONEYMAGIC.COM/](https://playmoneymagic.com/)
- [HTTPS://WWW.YOUTUBE.COM/WATCH?V=IN3GUGK6T7I](https://www.youtube.com/watch?v=IN3GUGK6T7I)
- [HTTPS://WWW.YOUTUBE.COM/WATCH?V=3I3UURDUDAM](https://www.youtube.com/watch?v=3I3UURDUDAM)
- [HTTPS://WWW.BRITANNICA.COM/TOPIC/SAVING](https://www.britannica.com/topic/saving)
- [HTTPS://BQK-KOS.ORG/EDU/WP-CONTENT/UPLOADS/2020/04/BROSHURA-1-FINAL-FINAL.PDF](https://bqk-kos.org/edu/wp-content/uploads/2020/04/broshura-1-final-final.pdf)
- [ARTIKULLIU-PER-KREDI-PDF.PDF \(BQK-KOS.ORG\)](#)
- [HTTPS://BQK-KOS.ORG/EDU/WP-CONTENT/UPLOADS/2020/04/BROSHURA-2-FINAL.PDF](https://bqk-kos.org/edu/wp-content/uploads/2020/04/broshura-2-final.pdf)